



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

MBANI NË MEND: KËTO JANË NJË MODEL I RREGULLAVE TË TENDERIT PËR SPINOF TË RREGULLT PËR TENDERIN DHE SHITJEN E CILESDO, NJË NDËRMARRJEJE SHOQËRORE. PËR INFORMATA SHITESË JU LUTEMI KONTAKTONI NJESINE E MARKETINGUT-MARREDHENJET ME KLIENTE / INVESTITOR TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT .

**Rregullat e Tenderit
për privatizimin e
Ndërmarrjes së Re “Famipa” Sh.P.K./Vala 49 e privatizimit përmes metodës spin-off**

Këto rregulla tenderi përcaktojnë udhëzimet dhe procedurat për dorëzimin e ofertës (siç është definuar këtu) në tenderin për subjektin e ri (siç është definuar këtu). Një person, përmes pjesëmarrjes në çfarëdo në çfarëdo aspekti të tenderit, pajtohet dhe ndërmerr masa t’iu nënshtrohet kushteve të këtyre rregullave të tenderit.

1. Përkufizimet dhe Interpretimet

1.1 Përkufizimet

Përkufizimet në vijim do të zbatohen në këto rregulla tenderi përveç në rastet ku sipas kontekstit kërkohet ndryshe:

“Kompania vartëse” nënkupton çfarëdo korporate ose subjekti afarist të cilën:

- (1) (a) Ofertuesi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi e ka në pronësi dhe të cilën gjithashtu e kontrollon Ofertuesi ose (b) është në pronësi ose nën kontroll të Ofertuesit. Për qëllim të këtij definicioni kuptimi i fjalës “pronësi” duhet të nënkuptojë pronësi të mbi 50% të kapitalit të aksioneve të asnjë lloji korporate ose pronësi mbi 50% të interesave në atë subjekt tjetër; ose

- (2) (b) Ka marrëdhënie bashkëpunimi me Ofertuesin të ndërtuar përmes një instrumenti me shkrim që është ligjërisht i detyrueshëm si (i) marrëveshje për pjesëmarrje të përbashkët, (ii) ndërmarrje në pronësi të përbashkët, ose (iii) ka kontratë për shërbime menaxheriale. Obligimet e palëve nën kësi lloj instrumenti të shkruar duhet qartësisht të (a) jenë të lidhura me Aktivitetin e kërkuar për biznes të post privatizimit të subjektit të ri; (b) të krijoj shkallë materiale të përfshirjes për secilën palë në pajtim me normat e standardeve industriale të Aktiviteteve të kërkuara për biznes; (c) të theksojë premtimet dhe zotimet e dhëna materiale nga secila palë në mbështetje të Aktiviteteve të parapara të biznesit të subjektit të ri; dhe (d) të theksojë angazhimet, detyrimet dhe përgjegjësitë të secilës prej palëve në mbështetje të aktiviteteve të sipër përmendura nën (a), (b) dhe (c) .

“Agjencia” nënkupton Agjencinë Kosovare të Privatizimit (këtej e tutje “Agjencia”) e cila sipas Ligjit Nr. 03/L-067 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit është organ i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur. Gjithashtu duke u bazuar në nenin 10 të këtij ligji, Agjencia ishte themeluar në pajtim me Rregulloren 2002/12 “Mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”,

“Agjenti” nënkupton çdonjërin i cili vepron si agjent ose vepron drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë në emër të, ose sipas udhëzimeve të një personi tjetër, pa marrë parasysh nëse veprimet e tilla bëhen në mënyrë të zbuluar ose të pazbuluar.

“Ligji në fuqi” do të thotë (i) Ligji në Fuqi në Kosovë i përcaktuar me Rregullorën e UNMIK-ut Nr.1999/24 mbi “Ligjin në Fuqi” në Kosovë të datës 2 dhjetor 1999, me ndryshime, mbi “Ligjin në Fuqi” në Kosovë; dhe (ii) ligjet dhe aktet nënligjore të shpallura ose të nxjerra në mënyrë të ligjshme nga një autoritet publik i Republikës së Kosovës.

“Aset” do të thotë një aset ose pjesë e vogël mbi të cilin Agjencia ushtron autoritetin në përputhje me nenet 5.1 (a)(ii) dhe 5.1 (a)(iii) të ligjit në fuqi.

“Verifikimet e historikut” nënkupton çfarëdo hetimi ose verifikimi i bërë nga Agjencia apo në emër të Agjencisë për (i) konfirmimin e origjinës së mjeteve për çmimin e blerjes (ii) për qëllime të konfirmimit nga Agjencia që ofertuesi fitues i përkohshëm nuk është ofertues me ndalesë dorëzimi të ofertës, (iii) për qëllim të pajtimit me ligjin e zbatueshëm ose praktikat më të mira ndërkombëtare dhe (iv) çfarëdo verifikimi ose hetimi i cili mund të përcaktohet nga Agjencia.

“Pronari përfitues” nënkupton person ose persona fizik ose juridik apo subjekt ose subjekte, të cilët kanë pronësi ligjore ose përfituese të një pjese apo tërë ofertuesit, çfarëdo qoftë ajo e shfaqur apo e strukturuar, pavarësisht nga fakti se në emër të kujt është regjistruar prona e ofertuesit.

“Oferta” nënkupton informatat dhe dokumentet e përcaktuara në nenin 8 (duke përfshirë por duke mos u kufizuar me Çmimin e Ofertës), që është dorëzuar nga një ofertues i kualifikueshëm në pajtim me nenin 10.

“**Ofertuesi**” nënkupton çfarëdo ofertuesi të përkohshëm ose ofertuesi të kualifikueshëm ose ofertues fitues i përkohshëm, cilido prej këtyre, duke përfshirë ofertuesin me ndalesë ofertimi.

“**Depozita e ofertës**” nënkupton depozitën e kthyeshme të ofertës në shumë prej [**€ 100,000 (njëqind mijë euro)**] që i paguhet Agjencisë nga ofertuesi i kualifikueshëm në pajtim me nenin 9.2.

“**Çmimi i ofertës**” nënkupton shumën e ofertës e dhënë në euro (€) nga ofertuesi i kualifikueshëm për aksionet e subjektit të ri dhe artikujve tjerë të tenderuar.

“**Tarifa për dorëzimin e ofertës**” nënkupton tarifën e pakthyeshme për dorëzimin e ofertës në shumë prej **2,000 euro (dy mijë euro)** që i paguhet Agjencisë nga ofertuesi i kualifikueshëm në pajtim me nenin 9.1

“**Periudha për dorëzimin e ofertës**” nënkupton **13 Prill 2011** ndërmjet [**10:00 dhe 12:00**], koha e Kosovës, gjatë së cilës duhet të dorëzohet oferta në Agjenci, hollësitë e së cilës janë gjithashtu të dhëna në njoftimin për tender.

“**Formulari për dorëzimin e ofertës**” nënkupton dokumentin, i cili ka formën e përcaktuar në Shtojcën C, që dorëzohet nga secili ofertues i kualifikueshëm në pajtim me nenin 8.3(a)(i).

“**Bordi**” nënkupton Bordin e Drejtorëve të Agjencisë.

“**Ditë pune**” nënkupton ditën në të cilën bankat ose institucionet janë zakonisht të hapura për aktivitete në Prishtinë, Kosovë dhe veçanërisht duke i përfshirë në shtunat, të dielat si dhe pushimet publike në Kosovë.

“**Urdhëresë**” do të thotë urdhëresat e Agjencisë apo vendimet e marra nga Bordi i Agjencisë, të parapara në nenin 14 të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili është në fuqi.

“**Personi kontrollues**” nënkupton cilindo person fizik ose juridik ose subjekt sipas urdhrave, udhëzimeve dhe kontrollit të cilit një person juridik ose subjekt vepron, pavarësisht nëse personi kontrollues ka pozitë formale siç është, **vetëm si shembull**, pozita e drejtorit menaxhues, kryeshefit ekzekutiv, kryesuesit të bordit të drejtorëve apo pozitë tjetër siç është, **vetëm si shembull**, ndonjë aksionar i madh.

“**Korporatë**” do të thotë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare të regjistruar në Kosovë dhe e përcaktuar si të tillë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, nr. 02/L-123.

“**Kreditor**” do të thotë personi ose subjekti i cili ka një pretendim të vlefshëm si kreditor ndaj një ndërmarrje dhe/ose një Aseti.

“**Detyrimet rrjedhëse**” nënkupton disa borxhe dhe detyrime të caktuara të NSH-së, të cilat janë krijuar gjatë afarizmit të zakonshëm të NSH-së dhe të cilat janë paraqitur si **ilustrim** në një listë në memorandumun e informatave dhe informatat në lidhje me tojanë të përfshira në zyrën e të dhënave dhe të cilat përfshijnë si në vijim:

- (1) Detyrimet neto të NSh-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjobat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (2) Detyrimet e papaguara të NSh-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (3) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhjes normale të biznesit që:
 - a) Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyre në fuqi;
 - b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSh-së.
- (5) çfarëdo detyrime tjera që transferohen nga NSh-ja në subjektin e ri, e të cilat janë identifikuar në memorandumun e informatave (ose në çfarëdo azhurnimi të atij dokumenti) ose në zyrën e të dhënave.

“**Zyra e të dhënave**” nënkupton zyrën e të dhënave e themeluar nga Agjencia ku vendosen në dispozicion disa informata dhe dokumente në lidhje me NSh-në dhe artikujt e tenderuar për t’u inspektuar nga ofertuesit.

“**Llogaria e Caktuar**” nënkupton llogarinë bankare që është caktuar nga Agjencia për të pranuar Çmimin Blerës nga Ofertuesi i Përkohshëm Fitues, hollësitë e të cilit do ti sigurohen Ofertuesit të Përkohshëm Fitues nga Agjencia.

“**Drejtor**” do të thotë një anëtar të Bordit.

“**Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive**” do të thotë Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive.

“**Ofertuesi i kualifikueshëm**” nënkupton ofertuesin e mundshëm i cili në pajtim me nenin 6 është regjistruar si ofertues i kualifikueshëm.

“**Libri i ofertuesve të kualifikueshëm**” nënkupton librin konfidencial të ofertuesve të kualifikueshëm i cili përpilohet dhe mbahet nga Agjencia në pajtim me nenin 6.6.

“**Formulari për regjistrimin e kualifikueshmërisë**” nënkupton formularin i cili i lëshohet ofertuesit të kualifikueshëm nga Agjencia në pajtim me nenin 6.5, i cili dëshmon se ofertuesi i kualifikueshëm është regjistruar me sukses si ofertues i kualifikueshëm dhe është përfshirë në librin e ofertuesve të kualifikueshëm.

“**Numri i regjistrimit të kualifikueshmërisë**” nënkupton numrin unik të ofertuesit të kualifikueshëm i cili është lëshuar atij/asaj nga Agjencia në pajtim me këtë nen 6.6 dhe i cili numër është i shënuar në formularin për regjistrimin e kualifikueshmërisë.

“**Ndërmarrje**” do të thotë ndërmarrje mbi të cilën Agjencia ushtron autoritetin në përputhje me nenin 5.1 (a)(i) të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

“**Ofertuesi nga radhët e punonjësve**” nënkupton:

- (1) çfarëdo punonjësi apo punonjës të tanishëm të NSh-së që veprojnë të vetëm apo në ortakëri me çfarëdo personi tjetër; ose
- (2) çfarëdo subjekti ku një apo më shumë punonjës të NSh-së janë pronar përfitues të cilët mund të jenë ofertues të mundshëm.

“**Sekretaria Ekzekutive**” do të thotë sekretaria ekzekutive e Bordit të paraparë me nenin 11.5 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

“**RFJ dhe RSFJ**” do të thotë, respektivisht, Ish Republikën Federale të Jugosllavisë dhe Ish Republikën Socialiste Federale të Jugosllavisë.

“**Ofertuesi më i lartë**” nënkupton ofertuesin e kualifikueshëm i cili dorëzon ofertën me çmim më të lartë për subjektin e ri.

“**Çmimi i ofertës më të lartë**” nënkupton çmimin e ofertës më të lartë që është dorëzuar gjatë tenderit nga cilido ofertues.

“**Memorandumi i informatave**” nënkupton dokumentin (përshirë të gjitha azhurnimet e bëra) e përgatitur nga AKP-ja dhe që i është shpërndarë ofertuesve, ku jepen informata në lidhje me historikun e NSh-së, përfshirë këtu (por jo kufizuar në): (1) përmbledhja e historisë, vendndodhjes dhe aktivitetit afarist të NSh-së; (2) pasuritë kyçe të NSh-së; (3) ilustrimi i artikujve të tenderuar; (4) hollësitë lidhur me çfarëdo kontrate e cila transferohet tek subjekti i ri dhe (5) informata tjera në lidhje me NSh-në të cilat nga Agjencia konsiderohen si të nevojshme.

“**Kapitali themelues fillestar**” nënkupton **1,250 € (një mijë e dyqind e pesëdhjetë euro)**, i cili është paguar ose do të paguhet nga ana e Agjencisë në kapitalin themelues të subjektit të ri me qëllim të themelimit të subjektit të ri (për shmangien e dyshimit, kjo shumë duhet t’i paguhet (si kompensim) Agjencisë nga ofertuesi fitues i përkohshëm, e që është si shtesë ndaj çmimit të ofertës më të lartë, në pajtim me këto rregulla tenderi).

“**Pagesa fillestare**” nënkupton shumën e barabartë me 25% -shin (njëzetepesë përqindëshin) e totalit të çmimit të ofertës më të lartë **PLUS** kapitali themelues fillestar **MINUS** depozita e ofertës.

“Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar” do të thotë autoritetin përgjegjës të mandatuar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës së datës 26 Mars 2007, dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

“Ligji mbi Ndërmarrjet” do të thotë ligji mbi ndërmarrjet i RSFJ (77/88), i ndryshuar me ligjet e RSFJ-së Nr. 40/89, 46/90 dhe 61/90.

“Obligimi për Mbajtjen e Aktivitetit Aktual të Biznesit” nënkupton vazhdimin e aktivitetit aktual të biznesit të Ndërmarrjes së Re në të ardhmen nga ana e Blerësit.

“Menaxhmenti” do të thotë Drejtorin Menaxhues dhe Zëvendës Drejtorët Menaxhues të Agjencisë, kolektivisht dhe individualisht.

“Pjesë e vogël” do të thotë një pjesë prej 50 përqind ose më pak që është përkufizuar sipas Ligjit në Fuqi si pronë shoqërore në cilindo person juridik i cili përndryshe është në pronësi private.

“Pronar” do të thotë personi ose subjekti i cili ka një pretendim të vlefshëm në një të drejtë ose interes pronësor në një ndërmarrje ose aset.

“Të ardhurat” do të thotë të ardhurat nga shitja, transferimi ose likuidimi i një ndërmarrje ose asemi sipas neneve 6, 8 ose 9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, shuma neto e cilësdo pagesë e cila duhet të bëhet sipas Nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e Pronës së Patundshme.

“Ofertuesi i mundshëm” nënkupton çfarëdo personi fizik apo juridik ose subjekt i cili konkurren për t’u regjistruar si ofertues i kualifikueshëm në pajtim me nenin 4 të këtyre rregullave të tenderit.

“Ofertuesi me ndalesë ofertimi” nënkupton çfarëdo personi fizik ose juridik apo subjekt, për të cilin janë dhënë hollësi në nenin 3.1, e i cili nuk kualifikohet t’u regjistruar si ofertues i kualifikueshëm dhe rrjedhimisht i ndalohet dorëzimi i ofertës.

“Ofertuesi fitues i përkohshëm” nënkupton cilindo nga ofertuesi më i lartë, ofertuesi i dytë më i lartë, ofertuesi i tretë më i lartë i cili ka marrë njoftim nga Agjencia për përzgjedhjen si ofertues fitues i përkohshëm dhe i cili ka të drejtën e përfundimit të blerjes së subjektit të ri me çmimin e ofertës më të lartë.

“Ligji për Shoqëritë Tregtare” do të thotë Ligji nr. 02/L-123 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës të shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 39.

“Rregullorja mbi Ligjin Themelor të Punës” do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/27 e datës 8 Tetor 2001 “mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë” me ndryshimet dhe plotësimet e bëra kohë pas kohe.

“Aktiviteti i Kërkuar i Biznesit” nënkupton përvojën profesionale në përpunimin e metaleve së paku deri në 3 (tre) vitet e fundit, të çdo personi fizik, juridik apo subjekt i cili dorëzon një

aplikacion për përfshirje procesin e ofertimit dhe në Regjistrin e Ofertuesëve të Kualifikueshëm si Ofertues i Kualifikueshëm, dhe e cila përvojë duhet të dëshmohet para Agjencisë.

“Rregullorja mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve” do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/48 e datës 21 Tetor 2005 “mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Pasurisë së tyre me Autorizimin Administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, e trashëguar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

“Rregullorja mbi Transformimin e Pronës së Patundshme” do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/13 e datës 9 Maj 2003, “mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme Shoqërore”.

“Komision Shqyrtues” do të thotë një komision të themeluar sipas Nenit 24 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

“Përfaqësuesi” nënkupton cilindo person i cili është i autorizuar ligjërisht për të vepruar në emër të ofertuesit gjatë tenderit, përfshirë këtu negociimin në lidhje me, dhe nënshkrimin e, Kontratës për Shitjen e Aksioneve dhe çfarëdo dokumenti relevant me të njëjtin.

“Ofertuesi i dytë më i lartë” nënkupton ofertuesin e kualifikueshëm i cili dorëzon çmimin e ofertës së dytë për subjektin e ri.

Kontrata për shitjen e aksioneve” nënkupton marrëveshjen e lidhur ndërmjet ofertuesit fitues të përkohshëm dhe Agjencisë (ku Agjencia vepron në emër të NSH-së) sipas së cilës i tërë kapitali i nxjerrë në aksione i subjektit të ri i shitet ofertuesit fitues të përkohshëm duke pasur parasysh që Agjencisë i paguhet çmimi i ofertës më të lartë.

“NSH-ja” nënkupton Ndërmarrjen Shoqërore NPM “Famipa” Prizren (PRZ024), gjithashtu më parë e njohur si (i) Fi.Trepça 496/89 PS-PD “Famipa (31/12/1989), (ii) Fi. 7272/92 DD “Famipa” Prizren (24/11/1992) e themeluar sipas ligjeve të Republikës Federale të Jugosllavisë, ose cilit do ligj tjetër në fuqi.

“Ndërmarrje në Pronësi Shoqërore” do të thotë një person juridik (përveç një ndërmarrje në pronësi publike) e cila: a) me apo pas 1 Janarit 1989 (i) i nënshtrohet paragrafit 1 ose 2 të Nenit 2 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, ose (ii) i nënshtrohet paragrafit 3 të Nenit 2 të Ligjit mbi Ndërmarrjet dhe shumica e aseteve të së cilës kanë qenë në pronësi shoqërore ose shumica e kapitalit të së cilës ishte e përbërë nga kapitali shoqëror; dhe b) është regjistruar ose është dashur të regjistrohet në Kosovë sipas ligjit të atëhershëm në fuqi.

“Dhoma e Posaçme” do të thotë Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës e themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Rr. 2002/13 të datës 13 Qershor 2002, “mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit” me ndryshimet dhe plotësimet e saj të bëra kohë pas kohe.

“Subjekti i ri” nënkupton shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar e cila themelohet nga Agjencia (ku Agjencia vepron në emër të NSH-së) që do të pranojë artikujt e tenderuar dhe e cila do të

vihet në tender për shitje sipas tenderit.

“**Tender**” nënkupton procesin e tërësishëm përmes së cilit Agjencia bën shitjen e artikujve të tenderuar dhe të subjektit të ri, përfshirë këtu identifikimin e çmimit të ofertës më të lartë dhe shitjen e subjektit të ri ofertuesit fitues të përkohshëm.

“**Dokumentet e ofertës**” nënkuptojnë: (1) Njoftimin për tender; (2) një memorandum I informatave (a) ku jepet një përmbledhje e aktivitetit afarist të NSH-së dhe asetëve kyçe të saj,(b) së bashku me një ilustrim të detyrimeve rrjedhëse dhe (c) kontratave të cilat do t’I transferohen subjektit të ri, së bashku me informacionet e tjera; (3) këto Rregulla të Tenderit; (4)një marrëveshje për ruajtjen e sekretit afarist për t’u nënshkruar nga ofertuesit dhe Agjencia; dhe (5) modeli i Kontratës së Shitjes dhe modelin e deklaratave të transferit (duke përfshirë cilindo nga dokumentet e bashkangjitura).

“**Njoftimi për tender**” nënkupton njoftimin e lëshuar nga Agjencie përmes së cilit shpallet tenderi dhe ku ofrohen hollësitë specifike të tenderit.

“**Orari i tenderit**” nënkupton dokumentin ku caktohen periudhat kohore dhe datat e rëndësishme në lidhje me tenderit dhe i cili është i bashkangjitur në këtë dokument si Shtojcë A.

“**Artikujt e tenderuar**” nënkupton disa pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe disa detyrime rrjedhëse të NSH-së, hollësitë e të cilave janë të dhëna në memorandumin e informatave, të cilat tenderohen për shitje në pajtim me tenderin dhe të cilat do të transferohen në subjektin e ri brenda një afati kohor të arsyeshëm.

“**Ofertuesi i tretë më i lartë**” nënkupton ofertuesin e kualifikueshëm i cili dorëzon çmimin e ofertës së tretë më të lartë për subjektin e ri.

“**Transformim**” lidhur me personin juridik do të thotë cilado nga të mëposhtmet: bashkimi, transformimi, (ri-)regjistrimi, inkorporimi si shoqëri aksionare apo si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, si ortakëri apo si person tjetër juridik, falimentimi, likuidimi, paaftësia paguese, organizimi në formë të veçantë apo në subjekt tjetër ose çfarëdo ngjarje apo procesi tjetër përmes të cilit ndryshohen cilado nga të poshtëshënuarat lidhur me atë subjekt: identiteti ligjor, forma apo natyra, ose forma apo natyra e pronësisë apo kapitalit, selia, dhe nëse ngjarja apo procesi i tillë apo ndonjë pjesë e tij ka ndodhur në cilëndo kohë ndërmjet 22 Marsit 1989 dhe 13 Qershorit 2002.

1.2 Interpretimi

(a) Vetëm nëse konteksti e kërkon ndryshe:

- (i) termi person përfshin personat e zakonshëm, shoqatat e pakorporatizuara ose organet korporative
- (ii) çdo gjë që i referohet gjinisë mashkullore i referohet edhe gjinisë femërore dhe çdo gjë që i referohet gjinisë asnjënjëse i referohet gjinisë mashkullore dhe asaj femërore;

- (iii) çdo gjë që i referohet njëjësit i referohet edhe shumësit.
- (b) Titujt janë vënë vetëm për lehtësimin tuaj dhe nuk ndikojnë në strukturën apo interpretimin e këtyre Rregullave të Tenderit.
- (c) Çdo gjë që i referohet klauzolës nënkupton një klauzolë apo nën-klauzolë të këtyre Rregullave të Tenderit, varësisht prej rastit.
- (d) Nëse ndonjë term apo dispozitë në Rregulla të Tenderit konsiderohet të jetë jologjore apo dhe i padetyrueshëm në tërësi apo pjesërisht do të cilësohet jo pjesë e këtyre Rregullave të Tenderit, por kushtet tjera të mbetura të këtyre Rregullave të Tenderit nuk do të ndryshohen.

2. **Hyrje**

2.1 *Pasqyrë e përgjithshme e rolit të Agjencisë*

Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej “Agjencia”) themelohet si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj. Agjencia themelohet si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, me ndryshime, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.

Për informata shtesë në lidhje me Agjencinë ju lutemi vizitoni faqen e internetit të dhënë në vijim: www.pak-ks.org

2.2 *Struktura e shitjes dhe pasqyra e ofertës*

Agjencia në emër të NSh-së do të themeloj subjektin e ri dhe Agjencia do të mbaj në mirëbesim për NSh-në kapitalin e subjektit të ri të nxjerrë në aksione. Si pjesë integrale e Tenderit Agjencia do të kryej shitjen e kapitalit të subjektit të ri të nxjerrë në aksione, në emër të NSh-së dhe artikujt e tenderuar do të transferohen tek subjekti i ri për një kohë të caktuar.

Subjekti i ri do të tenderohet për shitje në ankand publik ndërkombëtarë në pajtim me procedurat e përcaktuara në këto rregulla të tenderit. Gjatë tenderit do të jetë një raund i ofertimit dhe këto rregulla të tenderit përcaktojnë procedurat që qeverisin tenderin, përfshirë këtu mënyrën sipas së cilës ofertuesi i mundshëm mund të regjistrohet si ofertues i kualifikueshëm, informatat dhe dokumentet që duhet të përfshihen në ofertë, identifikimin e çmimit të ofertës më të lartë dhe mënyrën se si të vazhdohet shitja e subjektit të ri ofertuesit fitues të përkohshëm.

Për t'u marrë parasysh, një ofertë duhet të jetë në pajtim me këto rregulla të tenderit. Me pjesëmarrjen e ofertuesit në çfarëdo faze të tenderit ose me dorëzimin e ofertës, ofertuesi pajtohet dhe ndërmerr masa që t'i nënshtrohet kushteve të këtyre rregullave për tender.

Me dorëzimin e ofertës, ofertuesi kupton dhe pajtohet se ai konkurrin për blerjen e subjektit të ri dhe artikujve të tenderuar, si dhe **Agjencia do të shes subjektin e ri vetëm me çmimin e ofertës më të lartë.**

Ofertuesi më i lartë do të ketë të drejtë që blerjen e subjekti të ri dhe artikujve të tenderuar ta bëjë vetëm me çmimin e ofertës më të lartë.

Nëse për çfarëdo arsye, shitja nuk vazhdohet me ofertuesin më të lartë atëherë ofertuesi i dytë më i lartë duke iu nënshtuar këtyre rregullave të tenderit do të ketë mundësinë, por nuk është i detyruar, të blejë subjektin e ri dhe artikujt e tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë. Nëse për çfarëdo arsye, shitja nuk vazhdohet me ofertuesin e dytë më të lartë atëherë ofertuesi i tretë më i lartë duke iu nënshtuar këtyre rregullave të tenderit do të ketë mundësinë, por nuk është i detyruar, të blejë subjektin e ri dhe artikujt e tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë.

2.3 Orari i tenderit

Agjencia do të përgatis orarin e tenderit. Ofertuesit nxiten dhe iu rekomandohet të konsultojnë orarin e tenderit në mënyrë që të informohen lidhur me periudhat kohore dhe datat e rëndësishme të përcaktuara në orarin e tenderit.

3. Ofertuesit me ndalesë ofertimi

3.1 Për qëllime të këtij tenderi, ofertuesit në vijim do të kenë ndalesë ofertimi:

- (a) Ndërmarrjet publike dhe shoqërore
- (b) Departamentet qeveritare agjencitë ose institucionet apo personat juridik ose subjektet për të cilët Qeveria e Kosovës është pronar përfitues apo person kontrollues;
- (c) Në rast të çfarëdo qeverie ose shteti sovran atëherë organet, departamentet, agjencitë dhe institucionet shtetërore apo personat juridik ose subjektet për të cilët qeveria ose shteti sovran është pronar përfitues ose person kontrollues.
- (d) personat fizik ose juridik të cilët aktualisht i nënshtrohet procedurave të falimentimit apo të josolvensës;
- (e) personat fizik që janë shpallur fajtor për ndonjë krim që është kryer pas muajit qershor 1999 apo që në ndonjë mënyrë tjetër i nënshtrohen procedurave penale;

- (f) personat fizik dhe juridik që: (i) nuk i kanë respektuar kushtet e ndonjë kontrate të lidhur me Agjencinë ose me çfarëdo ndërmarrje që administrohet nga Agjencia (ekzistenca dhe natyra e atij mosrespektimi do të përcaktohet nga Agjencia sipas zgjedhjes së saj), (ii) kanë borxh ose gjobë të pashlyer ndaj Agjencisë ose ndonjë ndërmarrje që administrohet nga Agjencia, (iii) që janë në listën e personave ose subjekteve për të cilët një organizatë njohur ndërkombëtare siç është “OFAC” ia kanë ndaluar Agjencisë, ose BE-së të kryejnë transaksione me të, përfshirë këtu listën e personave të cilët iu nënshtrohen sanksioneve ndërkombëtare ose rregullave për kontrollimin e eksportit, (iv) personat fizik ose juridik të cilët nuk kanë paguar gjobat e caktuara nga Agjencia ose që i nënshtrohen ndonjë kërkesëpadie ose kontesti (pa marrë parasysh nëse çështja e tillë është ngritur në gjykatë apo tjetërkund);
- (g) personat fizik dhe juridik të cilët sipas mendimit të arsyeshëm të Agjencisë:
- (i) kanë kryer akte të cilat i kanë mundësuar Agjencisë që në pajtim me nenin 15.2(e) të anulojnë një tender të privatizimit;
- (ii) në ndonjë mënyrë tjetër kanë shkelur rregullat e tenderit për çfarëdo tenderi të privatizimit të organizuar nga Agjencia; ose
- (iii) janë tërhequr nga pozita e tyre si ofertues fitues i përkohshëm në ndonjë tender të privatizimit më shumë se një (1) herë, përmes dështimit për të depozituar shumën e çmimit të ofertës së tyre fituese brenda periudhës së kërkuar nga Agjencia ose përmes refuzimit të tyre për të nënshkruar dokumentet e shitjes, **gjatë çfarëdo tenderi të privatizimit të organizuar nga Agjencia pas të ashtuquajturve tenderë të “Valës së 7-të”.**
- (h) personat fizik dhe juridik që veprojnë në cilësinë e Agjentit për çfarëdo personi ose subjekti që përmendet në nenin 3.1 nga pika (a) deri në pikën (g) ose cilido Agjent i cili nuk i ka bërë të ditur personat që i përfaqëson ashtu siç kërkohet nga këto rregulla për tender
- (i) subjektet juridike, ku pronarët përfitues ose personat kontrollues të tyre i takojnë kategorive të theksuara në 3.1 nga pika (a) deri (h) më lartë.
- 3.2 Çfarëdo oferte e dorëzuar nga një person me ndalesë ofertimi do të diskualifikohet automatikisht, pavarësisht nga fakti nëse oferta e tillë është në pajtim të plotë me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë Rregulla për Tender.

4. Hulumtimi paraprak

- 4.1 **Hulumtimi paraprak dhe mbledhja e informatave dhe analizat në lidhje me NSH-në, artikujt e tenderuar dhe subjektin e ri do të jenë përgjegjësi e, dhe në rrezik të, secilit ofertues.**
- 4.2 Agjencia themelon Zyrën e të Dhënave në lidhje me NSH-në dhe artikujt e tenderuar. Agjencia u lejon ofertuesve të kenë qasje në informatat dhe dokumentet që gjenden në zyrën e të dhënave në lidhje me NSH-në dhe artikujt e tenderuar, për qëllime të hulumtimeve paraprake që bëhen nga ata në lidhje me NSH-në dhe artikujt e tenderuar. Ofertuesit përmes kësaj janë të njoftuar për ekzistimin e zyrës të dhënave dhe konsiderohet se janë të njoftuar për përmbajtjen e asaj zyre.
- 4.3 Agjencia do të jetë përgjegjëse vetëm për të bashkërenduar qasjet e ofertuesve në zyrën e të dhënave. Ofertuesit mund të qasen në zyrën e të dhënave vetëm në ditët dhe kohën e specifikuar në orarin e tenderit. Agjencia mund t'ia pamundësojë qasjen çdo personi në zyrën e të dhënave dhe në çfarëdo apo të gjitha informatat dhe dokumentet tjera që kontrollohen nga Agjencia, ku personi i tillë sipas mendimit të Agjencisë nuk duket të jetë ofertues i sinqertë dhe i vërtetë.
- 4.4 Para dorëzimit të ofertave, Agjencia brenda kufijve të burimeve administrative të veta do të bëjë përpjekje të arsyeshme për t'iu mundësuar të gjithë ofertuesve të vizitojnë vendndodhjen dhe hapësirat e NSH-së dhe artikujve të tenderuar.
- 4.5 Agjencia do të jetë përgjegjëse vetëm për bashkërendimin e vizitave të ofertuesve në vendndodhjen dhe hapësirat e NSH-së dhe artikujve të tenderuar. Ofertuesit mund të vizitojnë vendndodhjen dhe hapësirat e NSH-së dhe artikujt e tenderuar vetëm në ditët dhe kohën e specifikuar në orarin e tenderit. Agjencia mund t'ia pamundësojë mundësinë e qasjes çdo personi në vendndodhjen dhe hapësirat e NSH-së dhe artikujve të tenderuar, ku personi i tillë sipas mendimit të Agjencisë nuk duket të jetë ofertues i sinqertë dhe i vërtetë.
- 4.6 Ofertuesit nuk do të kontaktojnë NSH-në në mënyrë të drejtpërdrejtë, kështu që ofertuesit do të ngrisin çështjet e tyre dhe do të caktojnë takimet vetëm me Agjencinë.
- 4.7 Me dorëzimin e ofertës ofertuesi pranon dhe konfirmon para Agjencisë që ka bërë hetime paraprake dhe vlerësime të pavarura lidhur me NSH-në, artikujt e tenderuar dhe të gjitha informatat dhe dokumentet që janë në zyrën e të dhënave dhe se ai është i kënaqur me kushtet dhe operimet e NSH-së, artikujve të tenderuar dhe me saktësinë e çfarëdo apo të gjitha informatave dhe dokumenteve që gjenden në zyrën e të dhënave.
- 4.8 **Moskryerja e hetimeve paraprake dhe vlerësimeve të pavarura në lidhje me NSH-në, artikujt e tenderuar, si dhe në lidhje me çfarëdo dhe të gjitha informatat dhe dokumentet që gjenden në zyrën e të dhënave nuk e liron ofertuesin nga kryerja e obligimeve të tij sipas Kontratës për Shitjen e Aksioneve dhe dokumenteve tjera përkatëse. As Agjencia e as NSH-ja nuk marrin përgjegjësi dhe rrezik për përfundimet dhe interpretimet e nxjerra nga cilido ofertues, pas hulumtimit paraprak të ofertuesit të tillë dhe hetimeve të pavarura si dhe vlerësimit të NSH-ve,**

artikujve të tenderuar dhe ndonjë apo të gjitha informatat dhe dokumentacionin në Zyrën e të Dhënave.

- 4.9 Çdo ofertë e cila varet nga hulumtimet e mëtutjeshme paraprake, hulumtimet tjera apo nga oferta e një ofertuesi tjetër do të konsiderohet si jo e plotë dhe e papranueshme nga ana e Agjencisë.
- 4.10 Si rezultat i rrethanave në Kosovë është e njohur dhe konfirmuar nga të gjitha palët përkatëse se një pjesë e informatave dhe dokumentacionit në lidhje me NSh-në dhe artikujt e tenderuar mund të kenë humbur, të jenë shkatërruar ose hequr nga vendndodhja dhe hapësirat e NSh-së dhe mund të konsiderohet si nuk janë në dispozicion. Për këtë arsye, ofertuesve iu tërhiqet vëmendja se çfarëdo analize e informatave ose dokumenteve mund të jetë jo e plotë dhe duhet të shoqërohet nga një vlerësim i thellë i NSh-së dhe artikujve të tenderuar. As Agjencia e as NSh-ja nuk marrin përgjegjësi ose obligim në lidhje me çfarëdo mungese në informatat dhe dokumentet që janë në dispozicion në lidhje me NSh-në dhe artikujt e tenderuar.
- 4.11 Nga Agjencia nuk kërkohet të përkthej çfarëdo informate ose dokumenti në lidhje me NSh-në, artikujt e tenderuar dhe subjektit të ri për përkthyesit apo të ofrojë shërbime të interpretimit. Ofertuesi është përgjegjës për çdo interpretim ose përkthim të informatave dhe dokumenteve gjatë procesit të hulumtimit paraprak. Personat të cilët ofertuesit i ofrojnë shërbime interpretimi ose përkthimi duhet t’iu përshtaten obligimeve për ruajtjen e sekretit afarist të përcaktuara në këto rregulla tenderi dhe Agjencia kërkon që ata persona të nënshkruajnë deklaratën për ruajtjen e sekretit afarist.
- 4.12 Ofertuesi duhet të nënshkruaj **Marrëveshjen për ruajtjen e sekretit afarist** e cila është e përfshirë në dokumentet e tenderit dhe ta kthejë atë në Agjenci para se ofertuesit t’i lejohet të ketë qasje në informata dhe dokumentacion në Zyrën e të Dhënave apo të vizitojë vendndodhjen dhe hapësirat e NSh-së ose artikujve të tenderuar për qëllime të kryerjes së hulumtimit të tyre paraprak. Gjithashtu, nga ofertuesi kërkohet që të bë dakord me rregullat e zyrës të të dhënave para se t’i mundësohet qasja në zyrën e të dhënave.

5. Marrja e dokumenteve të tenderit

- 5.1 Ofertuesit kanë të drejtë të marrin kopje të dokumenteve të tenderit.
- 5.2 Në njoftimin për tender, ofertuesit udhëzohen që të kontaktojnë me shkrim personin e caktuar në Agjenci përpara afatit përfundimtar të lajmëruar për marrjen e dokumenteve përkatëse të tenderit.
- 5.3 Agjencia bën përpjekje të sigurojë dokumentet e ofertimit për ofertuesit brenda 3 ditësh pune nga pranimi i kërkesës për dokumentet e tenderit dhe dokumentet e tenderit zakonisht dërgohen ofertuesve pa pagesë, nëse të njëjta i dërgohen ofertuesit nga Agjencia përmes postës elektronike ose postës së rregullt. Ofertuesi që dëshiron të marrë

dokumentet e ofertës në ndonjë mënyrë tjetër atëherë merr përsipër mbulimin e shpenzimeve të asaj mënyre.

6. Procedurat për regjistrimin e kualifikueshmërisë.

6.1 Ofertuesit me ndalesë regjistrimi nuk kualifikohen për regjistrim si ofertues të kualifikueshëm.

6.2 Për të qenë i kualifikueshëm për dorëzimin e ofertës gjatë tenderit, ofertuesit e mundshëm duhet të jenë të regjistruar si ofertues të kualifikueshëm.

6.3 Për t'u regjistruar si ofertues i kualifikueshëm, së paku 5 ditë pune para periudhës për dorëzimin e ofertës ofertuesi i mundshëm duhet të dorëzojë aplikacionin për regjistrim si ofertues i kualifikueshëm. Agjencia do të regjistroj një ofertues të mundshëm si ofertues i kualifikueshëm vetëm nëse Agjencia ka përcaktuar se ofertuesi i tillë ka përmbushur kushtet e regjistrimit të përcaktuara në nenin 6.

6.4 Për qëllim të procedurave për para kualifikim, ofertuesi i mundshëm duhet që Agjencisë të dorëzojë informata, dokumente dhe dëshmi të dokumentuara deri në atë masë që sipas zgjedhjes së Agjencisë të jenë të pranueshme, se i plotëson kriteret në vijim:

- (a) Dëshmitë se ai apo ndonjë kompani partnere ka një ekip profesional menaxhues që mund të dëshmojë një përvojë profesionale në përpunimin e metaleve së paku deri në tri (3) vitet e fundit;
- (b) Dëshmitë se ai posedon një ekip të aftë dhe profesional të personelit për zbatimin e aktivitetit të ndërmarrjes;
- (c) Në rast se Ofertuesi i mundshëm zotëron Kompani vartëse ashtu si është definuar në pjesën 2) të definicionit mbi Kompaninë vartëse në këto Rregulla të Tenderit, Ofertuesi i mundshëm duhet të sigurojë për Agjencinë një kopje të një dokumenti me shkrim dhe ligjërish detyrues që rregullon marrëdhëniet e Ofertuesit të mundshëm me atë Kompani vartëse, dhe ai dokument duhet të përmbajë informacionet që thirren në pikat (a)-(d) të pjesës 2) të definicionit mbi Kompaninë vartëse në këto Rregulla të Tenderit .

6.5. Secili Ofertues nga radhët e punëtorëve duhet t'i ofrojë Agjencisë dëshmi të dokumentuara, deri në atë masë që sipas zgjedhjes së Agjencisë të jenë të pranueshme, se Ofertuesi nga radhët e punëtorëve plotëson kushtet që vijnë:

(a) Ai ose Kompania partnere kanë ekip menaxherial me përvojë substanciale në operim ose drejtim të biznesit baza e të cilit biznes është Aktiviteti i Kërkuar i Biznesit; dhe

(b) Në rast se Ofertuesi nga radhët e punëtorëve zotëron kompani vartëse ashtu si është definuar në pjesën 2) të definicionit mbi Kompani vartëse në këto Rregulla të Tenderit, Ofertuesi nga radhët e punëtorëve duhet t'i ofrojë Agjencisë kopje me shkrim të një dokumenti ligjor detyrues që rregullon marrëdhëniet e Ofertuesit nga radhët e punëtorëve me atë Kompani vartëse, dhe ai dokument duhet të përmbajë informatat e përmendura në pikat nga (a) deri në (d) të pjesës 2 të definicionit mbi Kompaninë vartëse në këto Rregulla të Tenderit.

6.5.1 Ofertuesit e mundshëm duhet gjithashtu të paraqesin në Agjenci informatat dhe dokumentacionin në vijim:

- (a) emri i ofertuesit, adresa dhe hollësi tjera për kontaktim, si dhe emrin dhe hollësitë për kontaktim të përfaqësuesit i cili shërben si person kryesor kontaktues me Agjencinë
- (b) informatat e mëposhtme në lidhje me ofertuesin e mundshëm:
 - (i) në rast se ofertuesi është **person fizik** atëherë një kopje të vërtetuar të letërnjoftimit ose pasaportës së tij;
 - (ii) nëse ofertuesi i mundshëm është **person juridik** atëherë një kopje të vërtetuar të certifikatës së regjistrimit të aktivitetit të tij afarist dhe identitetin e pronarëve përfitues dhe personave kontrollues. (vërtetimi i identitetit të pronarëve përfitues dhe personave kontrollues sipas këtij neni 6.5(b)(ii) nuk kërkohet nga subjektet juridike të cilat gjenden në listat e bursave ndërkombëtarisht të njohura, duke pasur parasysh që listat e tilla janë në dispozicion).
 - (iii) nëse ofertuesi i mundshëm është **ortakëri** atëherë një kopje të vërtetuar të dokumenteve themeluese të ortakërisë dhe identitetin e ortakëve, si dhe pronarëve përfitues dhe personave kontrollues.
 - (iv) në rast se ofertuesi i mundshëm është **konzorcium** i përbërë prej **personave fizik, ortakërive** dhe **kompanive** atëherë kopjet e vërtetuara të dokumenteve themeluese të atij konzorciumi, së bashku me kopjet e vërtetuara të letërnjoftimeve, pasaportave dhe të dhënat e regjistrimit të biznesit të pjesëmarrësve në konzorcium, përfshirë këtu edhe të dhënat mbi identitetin e pronarëve përfitues dhe personave kontrollues të anëtarëve të konzorciumit; ose
 - (v) në rast se ofertuesi i mundshëm dorëzon ofertë në cilësinë e agjentit të një pale tjetër atëherë duhet të jepet deklarata për një përfaqësim të tillë, emri dhe të dhënat e asaj pale tjetër së bashku me informatat me atë palë siç përcaktohet nga neni 6.5(b)(i) deri te nenin 6.5(b)(iv) më lartë, përfshirë këtu të dhënat mbi identitetin e pronarëve përfitues dhe personave kontrollues të anëtarëve të konzorciumit.

- (vi) një deklaratë me shkrim ku thuhet që ofertuesi nuk është ofertues me ndalesë ofertimi, së bashku me çfarëdo dokumente përkrahëse që duket relevante.
- 6.6 Secilit ofertues që regjistrohet si ofertues i kualifikueshëm, Agjencia do t'ia lëshojë Formularin për Regjistrimin e Kualifikueshmërisë dhe Numrin e Regjistrimit të Kualifikueshmërisë. Një ofertues i kualifikueshëm mund të shfrytëzojë formularin për regjistrimin e kualifikueshmërisë dhe numrin për regjistrimin e kualifikueshmërisë në çfarëdo tenderi që organizohet nga Agjencia në të ardhmen, përveç nëse formulari për regjistrimin e kualifikueshmërisë dhe numri për regjistrimin e kualifikueshmërisë anulohen apo që në ndonjë mënyrë tjetër përcaktohen nga Agjencia si jo të vlefshme, sipas zgjedhjes së Agjencisë.
- 6.7 Agjencia harton dhe mirëmban Librin e Ofertuesve të Kualifikueshëm.
- 6.8 Të gjitha informatat dhe dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi i mundshëm gjatë konkurrimit për regjistrim si ofertues i kualifikueshëm do të jenë me shkrim
- 6.9 Informatat dhe dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi i mundshëm gjatë konkurrimit për regjistrim si ofertues i kualifikueshëm duhet të jenë në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës (shqipe ose serbe) ose në gjuhën angleze (me përjashtim të pasaportave dhe/ose letërnjoftimeve të përmendura në nenin 6.5.1, të cilat sipas zgjedhjes së ofertuesit mund të dorëzohen në gjuhën origjinale).
- 6.10 Gjatë konkurrimit për regjistrim si ofertues i kualifikueshëm, ofertuesi i mundshëm konfirmon dhe përfaqëson se ka autoritet, të dhënë ose tjetër, për të zbuluar informatat dhe dokumentet e dhëna gjatë konkurrimit për regjistrim si ofertues i kualifikueshëm dhe se për zbulimin e tillë është siguruar pëlqimi nga personat fizik ose juridik ose subjektet e përmendura në informatat dhe dokumentet e tilla. Ofertuesi i mundshëm përmes konkurrimit për regjistrim si ofertues i kualifikueshëm gjithashtu pajtohet që Agjencinë ta mbajë të padëmtuar dhe ta kompensoj atë në rast të ngritjes së ndonjë padie nga çfarëdo personi ose subjekti në lidhje me zbulimin e tillë.
- 6.11 **Agjencia do të bëj përpjekje të arsyeshme që staffi i saj t'i trajtojë si konfidenciale të gjitha informatat e ofruara nga ofertuesi i mundshëm në aplikacionin për regjistrim si ofertues i kualifikueshëm dhe agjencia nuk do t'ia zbuloj ato palëve të treta përveç nëse: (a) kërkohet nga ligji i zbatueshëm ose nga ndonjë urdhëresë e lëshuar nga ndonjë gjykatë e juridiksionit kompetent ose (b) nga agjencitë për zbatimin e ligjit në Kosovë dhe jashtë saj ose (c) çfarëdo organi tjetër që është udhëzuar nga Agjencia me qëllim të verifikimit të historikut dhe çfarëdo hetime tjera të arsyeshme ose (d) nëse ofertuesi i mundshëm është pajtuar ndryshe me shkrim.**
- 6.12 Agjencia mban të drejtën për anulimin e regjistrimit të ofertuesit të kualifikueshëm dhe të fshijë ofertuesin e tillë nga Libri i Ofertuesve të Kualifikueshëm në çdo kohë nëse Agjencia përcakton se ofertuesi i kualifikueshëm është ofertues me ndalesë ofertimi ose

nëse ofertuesi i kualifikueshëm nuk është në ndonjë mënyrë tjetër në pajtim kërkesat e nenit 6.

- 6.13 Agjencia në çdo kohë, duke përfshirë përfundimin e shitjes së subjektit të ri mund të kërkoj nga ofertuesi të ofroj informata, konfirmime ose dokumente tjera të cilat i konsideron të nevojshme për konfirmimin e çfarëdo çështjeje të përmendur në këtë nen 6.

7. Verifikimi i historikut

- 7.1 Agjencia do të bëj verifikimin e historikut të ofertuesit fitues të përkohshëm.

- 7.2 Me dorëzimin e ofertës, secili ofertues i kualifikueshëm pranon dhe konfirmon se nëse ofertuesi i tillë pranon njoftimin nga Agjencia që ofertuesi i kualifikueshëm ka të drejtë të jetë ofertues fitues i përkohshëm atëherë:

- (a) nga ofertuesi i kualifikueshëm në fjalë kërkohet që Agjencinë ta furnizojë me çfarëdo dhe të gjitha informatat dhe dokumentet e kërkuara nga Agjencia për të lehtësuar kryerjen e verifikimeve të historikut;
- (b) Agjencia mund të shfrytëzoj institucionet relevante ose palë te treta të tjera që të bëjnë verifikimin e historikut në emër të Agjencisë dhe Agjencia do të ketë të drejtë të përdorë institucionet relevante ose palë te treta të tjera dhe të gjitha informatat dhe dokumentet të cilat i janë dhënë Agjencisë nga ana e ofertuesit fitues të përkohshëm për verifikimin e historikut;
- (c) përderisa Agjencia do të bëjë të gjitha përpjekjet brenda kompetencave të saj për të mundësuar përfundim të sa më të shpejtë të verifikimeve të historikut, një punë e tillë nuk është në kontrollin e Agjencisë dhe si rrjedhim Agjencia nuk mbahet përgjegjëse për çfarëdo vonese në përfundimin shitjes së subjektit të ri ose çfarëdo humbje pasuese që i shkaktohen ofertuesit fitues të përkohshëm e që ndërlihet me kohëzgjatjen e përfundimit të verifikimit të historikut.

- 7.3 Në rast se gjatë verifikimit të historikut gjenden dëshmi të kundërta në lidhje me ofertuesin fitues të përkohshëm atëherë Agjencia:

- (a) nuk përfundon shitjen e subjektit të ri ofertuesit fitues të përkohshëm në fjalë; dhe
- (b) nuk do të jetë përgjegjëse ndaj çfarëdo humbjeje ose dëmtimi pasues që i shkaktohet ofertuesit fitues të përkohshëm në fjalë; dhe
- (c) ia kthen pagesën fillestare ofertuesit fitues të përkohshëm.

8. Përmbajtja e ofertave

- 8.1 Vetëm ofertuesit e kualifikueshëm kanë të drejtë për të dorëzuar ofertë.

- 8.2 Ofertat duhet të dorëzohen në njërin nga gjuhë zyrtare të Kosovës (shqip dhe serbisht), ose në gjuhën angleze.
- 8.3 Ofertat duhet të dorëzohen si në vijim:
- (a) Informatat dhe dokumentet në vijim duhet të futen në një zarf të mbyllur me fjalët **“Informatat shtesë për ofertën”** të shtypura në pjesën e jashtme të zarfit:
 - (i) Originalin e formularit për dorëzimin e ofertës, e plotësuar dhe e nënshkruar nga apo në emër të ofertuesit të kualifikueshëm;
 - (ii) një kopje e formularit për regjistrimin e kualifikueshmërisë;
 - (iii) dokumenti bankar origjinal, që në thelb ka formën si në Shtojcën D, nga një bankë me mirënjohur (e jo ndonjë bankë e cila është e regjistruar në një vend i cili është në “listën e zezë” të Grupit Punues për Veprime Financiare (“FTAF”)), i cili konfirmon që ofertuesi ka mjete të mjaftueshme gjatë tërë periudhës së tenderit për të paguar çmimin e ofertës së tij (në mënyrën që kërkohet sipas këtyre rregullave për tender) dhe kapitalin themelues fillestar. **Ky dokument bankar nuk duhet të jap vlerën e çmimit të ofertës së ofertuesit;**
 - (iv) dëshmi e cila tregon që tarifa për dorëzimin e ofertës është transferuar në llogarinë e caktuar nga Agjencia për atë qëllim; dhe
 - (v) dëshmi e cila tregon që depozita e ofertës është transferuar në llogarinë e caktuar nga Agjencia për atë qëllim.
 - (b) çmimi i ofertës duhet të vendoset në një zarf të veçantë me fjalët **“Çmimi i ofertës”** të shtypura në pjesën e jashtme. **Në Shtojcën B të këtyre rregullave të tenderit është dhënë një tabelë për kalkulimin e shumës së përgjithshme të parave që duhet t’i paguhet Agjencisë nga ofertuesi i kualifikueshëm nëse ky çmimi i ofertës të ofertuesit të kualifikueshëm konsiderohet të jetë çmimi i ofertës më të lartë dhe ofertuesi i kualifikueshëm shpallet si ofertues fitues i përkohshëm. Ofertuesit e kualifikueshëm duhet të plotësojnë këtë tabelë dhe ta dorëzojnë atë me anë të zarfit të mbyllur me mbishkrimin **“Çmimi i Ofertës”****
 - (c) Zarfët e mbyllur të përmendur në 8.3(a) dhe 8.3(b) duhet së bashku të vendosen në një zarf të tretë të mbyllur me mbishkrimin **“Oferta për tenderin nr. 49”**. Në anën e jashtme të kësaj oferte të tretë nuk duhet të jepet asnjë informatë tjetër, si dhe asnjë informatë ose shenjë që mund ta identifikojnë ofertuesin e kualifikueshëm.

- (d) Pas pranimit të ofertës nga Agjencia, në zarfin e tretë të mbyllur e të përmendur në 8.3(c) do të shkruhet një numër dhe i njëjti do të regjistrohet në dëftesën e cila lëshohet nga Agjencia në pajtim me nenin 10.3.

9. Tarifa për dorëzimin e ofertës dhe depozita e ofertës

- 9.1 Për kompensimin e kostove administrative dhe të komunikimit të cilat janë të lidhura me shqyrtimin dhe përpunimin e ofertave, secili ofertues i kualifikueshëm së bashku me ofertën e tij duhet të dorëzojë tarifën për dorëzimin e ofertës. Tarifa për dorëzimin e ofertës paguhet me anë të një transferi bankar në llogarinë bankare të caktuar nga Agjencia për atë qëllim.
- 9.2 Për të siguruar vullnetin e mirë të ofertuesve të kualifikueshëm, secili ofertues i tillë së bashku me ofertën në Agjenci do të dorëzojë depozitën e ofertës. Depozita e ofertës paguhet me anë të një transferi bankar në llogarinë bankare të caktuar nga Agjencia për atë qëllim. Agjencia e krediton depozitën e ofertës së paguar nga ofertuesi fitues i përkohshëm ndaj shumës së përgjithshme të çmimit të ofertës më të lartë dhe kapitalit themelues fillestar që i paguhet Agjencisë për përfundimin e blerjes së subjektit të ri.
- 9.3 Agjencia do të bëjë përpjekje që ofertuesve të kualifikueshëm të cilët gjatë periudhës për dorëzimin e ofertës me çmimin më të lartë t'ua kthejë depozitën e ofertës brenda **10** (dhjetë) ditë pune pas përfundimit të periudhës për dorëzimin e ofertës.
- 9.4 Depozita e ofertës nuk kthehet nga Agjencia ofertuesve të kualifikueshëm të cilëve ju është konfiskuar depozita e tillë në mënyrën e cila është paraparë me këto rregulla tenderi.

10. Dorëzimi i ofertave

- 10.1 Gjatë tenderit do të ekzistojë vetëm një raund i ofertimit.
- 10.2 Të gjitha oferta duhet të dorëzohen në Agjenci gjatë periudhës për dorëzimin e ofertës, në zyrat e Agjencisë në Prishtinë. Agjencia nuk i pranon ofertat të cilat paraqiten jashtë periudhës për dorëzimin e ofertës ose që paraqiten në ndonjë vendndodhje tjetër.
- 10.3 Personit, i cili dorëzon ofertë në emër të ofertuesit të kualifikueshëm në kohën e dorëzimit të saj, do t'i jepet një dëftesës e nënshkruar nga komisioni për pranimin e ofertave i përbërë nga punonjës të Agjencisë, ku theksohet data, ora dhe minuta e pranimit të ofertës nga Agjencia. Personi i cili dorëzon ofertën nuk e identifikon ofertuesin e kualifikueshëm në emër të të cilit dorëzon ofertën. Përcaktimi i komisionit të Agjencisë për kohën e dorëzimit të ofertës do të jetë përfundimtar dhe ndaj tij nuk mund të ushtrohet ankesë në ndonjë gjykatë ose organ tjetër.

- 10.4 Ofertat do të hapen nga Agjencia para publikut brenda tri orëve pas përfundimit të periudhës për dorëzimin e ofertës. Agjencia do të bëjë identifikimin dhe shpalljen publike të ofertës me çmimin më të lartë.
- 10.5 Me dorëzimin e ofertës, ofertuesi do të jetë i obliguar t’iu përmbahet kushteve të ofertës të paraqitura në vijim:
- (a) Ofertuesi fitues, përveç çmimit të ofertës fituese, do të kompensojë Agjencinë për kapitalin themelues fillestar .
 - (b) Duke mos pasur paragjykime ndaj çfarëdo dispozite të këtyre “Rregulla të Tenderit”, “Ofertuesi fitues” duhet t’ia sigurojë Agjencisë të gjitha informatat dhe dokumentet e kërkuara nga Agjencia me qëllim që (i) të përmbushin nevojat e hetimeve dhe procedurave për larjen e parave të pista, (ii) me qëllim të kryerjes së hetimeve nga Agjencia për të konfirmuar origjinën e fondeve për çmimin blerës, (iii) me qëllim që Agjencia të konfirmoj se Ofertuesi Fitues është i kualifikueshëm sipas nenit 6.4 të këtyre rregullave të tenderit dhe/ose (iv) me qëllim që të arrihet pajtueshmëri me cilindo ligj të aplikueshëm ose praktika të mira ndërkombëtare, ashtu siç përcaktohet nga “Agjencia”.

11. Klasifikimi i ofertave dhe përzgjedhja e tyre

- 11.1 Pas dorëzimit të ofertave nga ofertuesit e kualifikueshëm në pajtim me nenin 10.2, Agjencia në pajtim me nenin 10.4 do të bëjë identifikimin e çmimit të ofertës më të lartë që është dorëzuar nga ofertuesi më i lartë.
- 11.2 Agjencia do të bëjë shitjen e subjektit të ri me çmimin e ofertës më të lartë.
- 11.3 Duke iu nënshtruar kushteve tjera të përcaktuara në këto rregulla për tender, subjekti i ri i shitet ofertuesit më të lartë sipas kushteve në vijim:
- (a) Agjencia brenda **3 ditë pune** nga periudha për dorëzimin e ofertës njofton ofertuesin fitues se i njëjti është ofertues fitues i përkohshëm.
 - (b) brenda **20 ditë pune** pasi që ofertuesi fitues njoftohet nga Agjencia se është ofertues fitues i përkohshëm, ofertuesi fitues do të paguaj pagesën fillestare në llogarinë e caktuar.
 - (c) në rast se ofertuesi fitues për çfarëdo arsye nuk bën pagesën fillestare në llogarinë e caktuar, brenda **20 ditë pune** pasi që ofertuesi fitues njoftohet nga Agjencia se është ofertues fitues i përkohshëm atëherë ofertuesit fitues do t’i merret e drejta për kryerjen e blerjes së subjektit të ri dhe do t’i konfiskohet depozita e ofertës;
 - (d) Agjencia do të bëjë aranzhimet për verifikimin e historikut të ofertuesit fitues dhe Agjencia do të njoftoj ofertuesin fitues në lidhje me rezultatet e verifikimit të tillë.

- (e) Në rast se gjatë verifikimit të historikut gjenden dëshmi të kundërta në lidhje me ofertuesin më të lartë të përkohshëm atëherë Agjencia do të njoftoj ofertuesin më të lartë dhe do të veproj në pajtim me nenin 7.3, si dhe Agjencia do të shkoj tutje për të kontaktuar ofertuesin e dytë më të lartë në pajtim me nenin 11.4.
 - (f) Në rast se gjatë verifikimit të historikut **nuk** gjendet dëshmi të kundërta në lidhje me ofertuesin më të lartë atëherë Agjencia do të njoftoj ofertuesin më të lartë dhe ky i fundit do të paguaj **75%** (shtatëdhjetë e pesë për qind) të çmimit të ofertës më të lartë në llogarinë e caktuar brenda **20 (njëzet) ditë pune** pas ditës kur Agjencia njofton ofertuesin më të lartë në lidhje me rezultatet e verifikimit të historikut.
 - (g) nëse ofertuesi më i lartë për çfarëdo arsye **nuk paguan 75%** (shtatëdhjetë e pesë për qind) të çmimi të ofertës më të lartë në llogarinë e caktuar brenda **20 (njëzet) ditë pune** pas ditës kur Agjencia njofton ofertuesin më të lartë në lidhje me rezultatet e historikut atëherë ofertuesit më të lartë do t'i merret e drejta për blerjen e subjektit të ri dhe do t'i konfiskohet depozita e ofertës.
- 11.4 Në rast se **nuk arrihet që subjekti i ri t'i shitet ofertuesit më të lartë fitues** atëherë AKP-ja do të kontaktojë me shkrim ofertuesin e dytë më të lartë duke kërkuar nëse dëshiron që të blej subjektin e ri me çmimin e ofertës më të lartë. Ofertuesi i dytë më i lartë brenda **3 ditë** pune pas pranimit të kërkesës nga Agjencia njofton të njëjtën me shkrim nëse dëshiron të vazhdojë me blerjen e subjektit të ri me çmimin e ofertës më të lartë. Nëse AKP-ja nuk pranon njoftimin e tillë me shkrim nga ofertuesi i dytë më i lartë atëherë AKP-ja do të ketë të drejtën që dështimin e ofertuesit të dytë më të lartë për të kthyer përgjigje ta trajtojë si refuzim të ftesës së Agjencisë për blerjen e subjektit të ri me çmimin e ofertës më të lartë. Nëse ofertuesi i dytë më i lartë nuk dëshiron të bëjë blerjen e subjektit të ri me çmimin e ofertës më të lartë atëherë Agjencia në pajtim me nenin 11.6 do të vazhdojë tutje të kontaktojë ofertuesin e tretë më të lartë.
- 11.5 Sipas nenin 11.4 dhe kushteve të tjera të përcaktuara në këto rregulla për tender, subjekti i ri i shitet ofertuesit të dytë më të lartë:
- (a) Brenda një **1 ditë** pune nga dita kur Agjencia pranon njoftimin me shkrim nga ofertuesi i dytë më i lartë sipas të cilit ofertuesi i dytë më i lartë shpreh dëshirën për të vazhduar me blerjen e subjektit të ri me çmimin e ofertës më të lartë, Agjencia do të njoftoj ofertuesin e dytë më të lartë se është ofertues fitues i përkohshëm.
 - (b) Në rast se depozita e ofertës i është kthyer ofertuesit të dytë më të lartë në pajtim me nenin 9.3 atëherë ofertuesi i dytë më i lartë brenda **2 ditë** pune pasi që është njoftuar nga Agjencia se ofertuesi i dytë më i lartë është ofertues fitues i përkohshëm do të transferojë depozitën e ofertës në llogarinë bankare të caktuar nga Agjencia për atë qëllim.

- (c) Brenda **20** (njëzet) ditë pune pasi që ofertuesi i dytë më i lartë njoftohet nga Agjencia se është ofertues fitues i përkohshëm, ofertuesi i dytë më i lartë do të bëjë pagesën fillestare në llogarinë e caktuar.
- (d) Në rast se ofertuesi i dytë më i lartë për çfarëdo arsye nuk bën pagesën fillestare në llogarinë e caktuar, brenda **20** (njëzet) ditë punë pasi që ofertuesi fitues njoftohet nga Agjencia se është ofertues fitues i përkohshëm, atëherë ofertuesit të dytë më të lartë do t'i merret e drejta për kryerjen e blerjes së subjektit të ri dhe do t'i konfiskohet depozita e ofertës;
- (e) Agjencia do të bëjë aranzhimet për verifikimin e historikut të ofertuesit të dytë më lartë dhe Agjencia do të njoftoj ofertuesin fitues në lidhje me rezultatet e verifikimit të tillë.
- (f) Në rast se gjatë verifikimit të historikut gjenden dëshmi të kundërta në lidhje me ofertuesin e dytë më të lartë atëherë Agjencia do të njoftoj ofertuesin e dytë më të lartë për një gjë të tillë dhe do të veproj në pajtim me nenin 7.3, si dhe Agjencia do të shkoj tutje për të kontaktuar ofertuesin e tretë më të lartë në pajtim me nenin 11.6.
- (g) Në rast se gjatë verifikimit të historikut nuk gjendet dëshmi të kundërta në lidhje me ofertuesin dytë më të lartë atëherë Agjencia do të njoftoj ofertuesin e dytë më të lartë për një gjë të tillë dhe ky i fundit do të paguaj 75% (shtatëdhjetepesë për qind) të çmimit të ofertës më të lartë në llogarinë e caktuar brenda **20** (njëzet) ditë pune pas ditës kur Agjencia njofton ofertuesin e dytë më të lartë në lidhje me rezultatet e verifikimit të historikut.
- (h) Nëse ofertuesi dytë më i lartë për çfarëdo arsye nuk paguan 75% (shtatëdhjetepesë për qind) të çmimit të ofertës më të lartë në llogarinë e caktuar brenda **20** (njëzet) ditë punë pas ditës kur Agjencia njofton ofertuesin e dytë më të lartë në lidhje me rezultatet e historikut atëherë ofertuesit të dytë më të lartë do t'i merret e drejta për blerjen e subjektit të ri dhe do t'i konfiskohet depozita e ofertës.

11.6 Në rast se nuk arrihet që subjekti i ri t'i shitet ofertuesit më të lartë ose ofertuesit të dytë më të lartë atëherë AKP-ja do të kontaktojë me shkrim ofertuesin e tretë më të lartë duke kërkuar nëse dëshiron që të blejë subjektin e ri me çmimin e ofertës më të lartë. Ofertuesi i tretë më i lartë brenda 3 ditë pune pas pranimit të kërkesës nga Agjencia njofton të njëjtën me shkrim nëse dëshiron të vazhdojë me blerjen e subjektit të ri me çmimin e ofertës më të lartë. Nëse AKP-ja nuk pranon njoftimin e tillë me shkrim nga ofertuesi i tretë më i lartë atëherë AKP-ja do të ketë të drejtën që dështimin e ofertuesit të tretë më të lartë për të kthyer përgjigje ta trajtojë si refuzim të ftesës së Agjencisë për blerjen e subjektit të ri me çmimin e ofertës më të lartë. Nenin 11.8 do të zbatohet për rastet ku ofertuesi i tretë më i lartë nuk dëshiron të bëjë blerjen e subjektit të ri me çmimin e ofertës më të lartë.

- 11.7 Sipas nenin 11.6 dhe kushteve tjera të përcaktuara në këto rregulla për tender, shitja e subjektit të ri do të vazhdohet me ofertuesin e tretë më të lartë ngjashëm me mënyrën e përshkruar në nenin 11.5. Në rastet e tilla termi ofertuesi i dytë më i lartë do të zëvendësohet në nenin 11.5 me termin ofertuesi i tretë më i lartë.
- 11.8 Duke mos u kufizuar në përgjithësinë e nenit 15.1 dhe pa pasur paragjykime për çfarëdo shkak të vonesës apo anulimit të tenderit të përcaktuar në këto rregulla për tender, në rast se shitja e subjektit të ri me ofertuesin më të lartë, ofertuesin e dytë më të lartë ose ofertuesit të tretë më të lartë nuk është e arritshme, sipas kushteve të këtij nenin 11, atëherë Agjencia do të ketë të drejtën që të shtyjë ose anulojë tenderi cilado që i duket më e përshtatshme.
- 11.9 Pavarësisht nga çdo gjë që është përcaktuar në nenin 11.3, përkatësisht nenin 11.5, asnjë ofertuesi fitues të përkohshëm nuk do t'i konfiskohet depozita e ofertës për shkak se ka dështuar në blerjen e subjektit të ri ose ka dështuar në kryerjen e pagesave të kërkuara brenda afateve të përcaktuara në nenin 11.3, respektivisht nenin 11.5 nëse ofertuesi fitues i përkohshëm mund të ofrojë dëshmi të pavarur dhe objektive, e pranueshme për Agjencinë, që tregon se dështimet e tilla janë rezultat i frikësimeve, detyrimeve ose kërcënimeve.
- 11.10 Në rast e ekzistojnë dy ose më shumë oferta të dorëzuara nga ofertuesit e kualifikueshëm e të cilat kanë çmime të njëjta atëherë klasifikimi i ofertave të tilla do të bëhet si në vijim:
- (a) në rast se në një nga ofertat merr pjesë një ose më shumë punonjës të NSH-së atëherë oferta e tillë do të jetë prioritare; ose
 - (b) nëse në asnjë nga ofertë ose dy e më shumë oferta të njëjta merr pjesë një apo më shumë punonjës të NSH-së atëherë prioritet do të ketë oferta e cila është dorëzuar më herët.
- përcaktimi(et) i Agjencisë se nëse në ofertë merr pjesë një ose më shumë punonjës të NSH-së dhe në lidhje me kohën e pranimit të ofertave është përfundimtar dhe ndaj këtij përcaktimi nuk mund të parashtrohet ankesë në gjykatë ose në ndonjë organ tjetër.
- 11.11 Mjetet që shfrytëzohen nga ofertuesi fitues i përkohshëm për të kryer pagesën e çmimit të ofertës më të lartë nuk paguhen në para të gatshme dhe nuk duhet të kenë origjinën nga ndonjë juridiksion që është në listën e zezë të FATF.

12. Modifikimi, tërheqja ose dorëzimi i vonuar i ofertave

Ofertuesi i kualifikueshëm nuk mund të modifikojë asnjë aspekt të ofertës së tij (përveç nëse bëhet me leje të Agjencisë) ose të tërheqë ofertën pas dorëzimit të saj në Agjenci. Nuk pranohet asnjë ofertë pas përfundimit të periudhës për dorëzimin e ofertave.

13. Negociatat për kontratën e shitblerjes.

- 13.1 Agjencia dhe ofertuesi fitues i përkohshëm do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të nënshkruar Marrëveshjen për Shitjen e Aksioneve brenda **90 ditëve të punës** nga data e njoftimi zyrtar të ofertuesit fitues për përzgjedhjen e tij nga ana e Agjencisë.
- 13.2 Agjencia sipas zgjedhjes së saj, duke njoftuar ofertuesin fitues të përkohshëm, mund ta zgjasë afatin e përshkruar në nenin 13.1, në rast se beson që ka nevojë të arsyeshme shtesë për qëllimi të negocimit të kushteve të Marrëveshjes për Shitjen e Aksioneve ose për shkak të disa rrethanave tjera që rezultojnë me shtyrje, siç janë (por jo kufizuar në) verifikimet e historikut.
- 13.3 Ofertuesi fitues i përkohshëm do të bëjë të gjitha përpjekjet për të realizuar Marrëveshjen për Shitjen e Aksioneve dhe çfarëdo dokumenti përkatës me Agjencinë.
- 13.4 Negociatat ndërmjet Agjencisë dhe ofertuesit fitues të përkohshëm në lidhje me Marrëveshjen për Shitjen e Aksioneve mbahen në minimum dhe ofertuesi fitues i përkohshëm nuk duhet të kërkojë ndryshimin e çmimit të ofertës më të lartë, artikujt e tenderuar e as të kërkojë ndryshim qenësor të çfarëdo përfaqësime dhe garanci ose çfarëdo kushte qenësore të Marrëveshjes për Shitjen e Aksioneve ose dokumenteve tjera.
- 13.5 Në rast se negociatat ndërmjet Agjencisë dhe ofertuesit fitues të përkohshëm në lidhje me Marrëveshjen për Shitjen e Aksioneve nuk janë të suksesshme (sipas mendimit të arsyeshëm të Agjencisë) brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 13. 1 (ose çfarëdo vazhdimi të afatit të tillë) atëherë Agjencia do të:
- (a) ketë të drejtë që të përcaktojë pamundësinë e realizimit të shitjes së subjektit të ri me ofertuesin fitues të përkohshëm sipas kushteve të pranueshme ndërmjet ofertuesit fitues të përkohshëm dhe Agjencisë; dhe
 - (b) Agjencia do të njoftojë ofertuesin fitues të përkohshëm për ndërprerjen e procesit të negociatave dhe të gjitha shumat e paguara nga ofertuesi fitues i përkohshëm, me përjashtim të tarifës për dorëzimin e ofertës, do t'i kthehen ofertuesit fitues të përkohshëm **duke pasur parasysh që** në rast se Agjencia përcakton se ofertuesi fitues i përkohshëm nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për realizimin e Marrëveshjes për Shitjen e Aksioneve dhe dokumentet tjera përkatëse, në pajtim me nenin 13.3 atëherë ofertuesit fitues të përkohshëm do t'i konfiskohet depozita e ofertës; dhe
 - (c) Agjencia sipas zgjedhjes së saj mund të kontaktojë me ofertuesin e kualifikueshëm të radhës i cili ka të drejtë që të njoftohet me shkrim për zgjedhjen si ofertues fitues i përkohshëm, për të kërkuar nëse dëshiron që të realizoj blerjen e subjektit të ri me çmimin e ofertës më të lartë. Në rrethana të tilla, mënyra e realizimit të shitjes së subjektit të ri do të përcaktohet nga dispozitat përkatëse të nenit 11.

14. Nënshkrimi i Marrëveshjes për Shitjen e Aksioneve

- 14.1 Marrëveshja për Shitjen e Aksioneve dhe çfarëdo dokumenti përkatës do të nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Agjencisë dhe një përfaqësuesi të autorizuar të ofertuesit fitues të përkohshëm. Agjencia mund të kërkojë nga përfaqësuesi i autorizuar i ofertuesit fitues të përkohshëm që t'i ofrojë Agjencisë dëshmi lidhur me autoritetin e tij të përfaqësuesit të ofertuesit fitues të përkohshëm për të nënshkruar kontratën e shitjes dhe dokumenteve mbështetëse në emër të ofertuesit fitues të përkohshëm.
- 14.2 Për t'iu shmangur dyshimit, Marrëveshja për Shitjen e Aksioneve dhe çfarëdo dokumente përkatëse nuk nënshkruhen nga Agjencia (në emër të NSh-së) dhe ofertuesit fitues të përkohshëm deri në kohën kur Agjencisë i paguhet shuma e përgjithshme e çmimit të ofertës më të lartë plus kapitali themelues fillestar, në mënyrë të pranueshme për Agjencinë.

15. Shtyrja ose anulimi i tenderëve

- 15.1 Bordi sipas zgjedhjes së tij mund të shtyjë dhe të anulojë tenderin në çfarëdo kohe ose për çfarëdo arsye.
- 15.2 Duke mos kufizuar përgjithësinë e nenit 15.1 dhe pa paragjykuar për çfarëdo shkakut tjetër të shtyrjes ose anulimit të tenderit të përcaktuar në këto rregulla për tender, Bordi në rrethanat e paraqitura në vijim mund të marrë vendim përmes së cilit Agjencia urdhërohet të shtyjë ose të anulojë tenderin:
- (a) në rast se nuk pranohen oferta të cilat i plotësojnë kriteret dhe i përmbushin kushtet e përcaktuara në këto rregulla për tender;
 - (b) nëse më pak se tre ofertues të mundshëm janë regjistruar si ofertues të kualifikueshëm në pajtim me nenin 6 të këtyre rregullave për tender;
 - (c) nëse më pak se tri oferta janë dorëzuar nga ofertuesit e kualifikueshëm gjatë periudhës për dorëzimin e ofertave;
 - (d) nëse sipas mendimit të bordit, çmimi i ofertës më të lartë nuk ka kurrfarë lidhje racionale me vlerën e perceptuar të artikujve të tenderuar dhe subjektit të ri. Bordi në këtë rast si shtesë mund të zgjedh shtyrjen e përcaktimit të ofertuesit fitues të përkohshëm deri në një datë të mëvonshme.
 - (e) nëse Agjencia merr sinjale, ose dyshon në, ekzistimin e ndonjë marrëveshje të fshehtë ndërmjet ofertuesve, përdorim të shtrëngimit ose kërcënimit nga një ofertues ose disa ofertues për t'ua kthyer mendjen ofertuesve tjerë në lidhje me pjesëmarrjen në çfarëdo aspekti të tenderit apo për të ndikuar në përmbajtjen e ofertave nga ofertues tjerë, apo çfarëdo aktiviteti joligjor ose të parregullt të kryer nga kushdo në lidhje me tenderin.
- 15.3 Në rastet kur tenderi anulohet për çfarëdo arsye atëherë:

- (a) Agjencia njofton me shkrim të gjithë ofertuesit e kualifikueshëm për anulimin e tillë;
- (b) Agjencia nuk mbahet përgjegjëse për çfarëdo kosto ose detyrime që i janë shfaqur cilido ofertues ose çfarëdo pale të tretë;
- (c) të gjitha depozitat e ofertave të marra dhe çfarëdo mjete tjera të pranuar nga Agjencia (përveç tarifës për dorëzimin e ofertës) do të kthehen nga Agjencia brenda 15 ditë puna nga data e anulimit **DUKE MARR PARASYSH** se Depozitat e Ofertës nuk do ti kthehen nga Agjencia asnjë Ofertuesi që u është konfiskuar Depozita e Ofertës së tyre në mënyrën që është ofruar sipas Rregullave të Tenderit.

16. Rezervimi i të drejtave nga ana e Agjencisë

16.1 *Amandamentet në afatet kohore*

Agjencia mund që sipas zgjedhjes së vet absolute të zgjas apo ndryshoj në çfarëdo kohe afatin e përmendur në këto Rregulla të Tenderit, ku Agjencia beson se nevojitet kohë shtesë e arsyeshme për qëllime të përfundimit të suksesshëm të shitjes së subjektit të ri apo si rezultat i disa rrethanave të tjera që rezultuan me vonesë.

16.2 *Amandamentet në kushtet e tenderit*

Agjencia mbanë të drejtën për të bërë ndryshime, modifikime ose ndërprerjen e cilësdo procedurë të përcaktuar në këto rregulla për tender, në çdo kohë gjatë tenderit, pa ndonjë njoftim paraprak dhe pa kurrfarë kosto ose përgjegjësi për Agjencinë. Amendamentet në këto rregulla për tender do të nxirren me shkrim nga Agjencia dhe do të bëhen publike, si dhe një kopje e rregullave për të tender të ndryshuara do ti dërgohet secilit ofertuesit të kualifikueshëm.

16.3 *Refuzimi i ofertuesit fitues*

Agjencia mund të refuzojë një ofertë të ofertuesit fitues të përkohshëm nëse kupton që informatat e dhëna në aplikacionin e ofertuesit fitues të përkohshëm për regjistrim si ofertues i kualifikueshëm ose çfarëdo informate tjetër në ofertën e ofertuesit fitues të përkohshëm janë të pasakta. Në një rast të tillë, nga Agjencia nuk kërkohet të vazhdojë me realizimin e shitjes së subjektit të ri me ofertuesin fitues të përkohshëm dhe Agjencia do të ndërpresë të gjitha negociatat me ofertuesin fitues të përkohshëm në lidhje me Marrëveshjen për Shitjen e Aksioneve. Ofertuesit fitues të përkohshëm si shtesë i konfiskohet depozita e ofertës dhe si rrjedhim Agjencia do të ketë të drejtën të kontaktojë ofertuesin e kualifikueshëm të radhës i cili ka të drejtën të njoftohet me shkrim se është ofertues fitues i përkohshëm, për të kërkuar nëse dëshiron të realizojë blerjen e subjektit të ri me çmimin e ofertës më të lartë. Në rrethana të tilla, mënyra e realizimit të shitjes së subjektit të ri do të përcaktohet nga dispozitat përkatëse të nenit 11.

16.4 *Marrëdhënia kontraktuese*

- (a) Qëllimi i këtyre rregulla të tenderit nuk është që të përbëjnë ndonjë memorandum marrëveshje ndërmjet Agjencisë dhe ofertuesve. Rrjedhimisht, nuk do të konsiderohet se ekziston ndonjë kontratë ndërmjet Agjencisë dhe një ofertuesi vetëm për shkak të pjesëmarrjes së ofertuesit të tillë në çfarëdo aspekti të tenderit.
- (b) Nuk do të ketë asnjë kontratë detyrimore ndërmjet Agjencisë dhe ofertuesit fitues të përkohshëm deri në hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për Shitjen e Aksioneve dhe as Agjencia e as NSh-ja nuk do të kenë asnjë marrëdhënie detyrimore me ofertuesin fitues të përkohshëm. Kushtet e memorandumit të informatave ose dokumentet tjera të tenderit nuk do të interpretohen si ofertë.

16.5 *Mospranimi*

Agjencia dhe përfaqësuesit e saj për aq sa është e lejuar me ligj në mënyrë të qartë nuk pranojnë:

- (a) çfarëdo dhe të gjitha përgjegjësitë për përfaqësimet, garancitë apo deklaratat që ndodhen në çdo material të siguruar (përfshirë këtu, pa u kufizuar në, memorandumin e informatave dhe informatat në zyrën e të dhënave) apo në çfarëdo informate që i është transmetuar gojarisht ofertuesit; dhe
- (b) çfarëdo përfaqësime dhe garanci që përfshihen në çfarëdo ligji.

16.6 *Gjuha*

Këto rregulla për tender janë përgatitur në gjuhën shqipe, serbe, si dhe në gjuhën angleze.

16.7 *Mundësitë e anulimit të kontratës së shitjes*

Pavarësisht nga neni 10.5 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ose nga dispozitat tjera të ligjit të zbatueshëm, nëse përcaktohet se (a) mjetet e përdorura nga ofertuesi fitues i përkohshëm për blerjen e subjektit të ri rrjedhin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga aktiviteti joligjor ose (b) gjatë tenderi blerësi ka qenë i përfshirë në marrëveshje të fshehtë ose në çfarëdo shkelje të rregullave të tenderit atëherë Marrëveshja për Shitjen e Aksioneve mund të anulohet nga Agjencia.

17. **Zgjidhja e kontesteve**

- 17.1 Duke iu nënshtruar nenit 17.2 më poshtë, vendimet e Agjencisë që vijnë sipas këtyre rregullave për tender ose në përgjithësi sipas tenderit janë përfundimtare dhe ndaj tyre nuk mund të ushtrohet ankesë në gjykatë ose në ndonjë organ tjetër. Ofertuesit nuk kanë të drejtë të parashirojnë padi në çfarëdo gjykate brenda ose jashtë Kosovës në lidhje me

ndryshimin e vendimit të Agjencisë ose për kompensimin e kostove dhe detyrimeve që dalin si rezultat i vendimit të Agjencisë, deri në atë masë që lejohet me ligjin e zbatueshëm.

- 15.2 Pavarësisht nga klauzola paraprake, palët pranojnë dhe pajtohen që Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka juridiksion ekskluziv dhe përfundimtar mbi Agjencinë.

[PJESA NË VAZHDIM E KËSAJ FAQEJE ËSHTË LËNË E ZBRAZËT ME QËLLIM]

SHTOJCA A

“ORARI I TENDERIT”

Përmbledhja e orarit të tenderit

<i>Data</i>	<i>Nga</i>	<i>Deri</i>	<i>Kohëzgjatja</i>
Botimi i njoftimit për tender			
Vizitat për hulumtim paraprak			30 ditë
Dorëzimi i ofertave	10:00	12:00	
Vlerësimi i ofertave dhe identifikimi i çmimit të ofertës më të lartë	13:00	16:00-17:00	3-4 ore
Informimi i ofertuesve të kualifikueshëm për rezultatet e tenderit			3 ditë
Negocimi i Marrëveshjes për Shitjen e Aksioneve me ofertuesin fitues të përkohshëm			90 ditë
Transferimi i artikujve të tenderuar në subjektin e ri / nënshkrimi i Marrëveshjes për Blerjen e Aksioneve			

SHTOJCA B

“Çmimi i Ofertës që Ofertuesi i Përkohshëm Fitues duhet t’i paguajë Agjencisë”

Emri i Plotë i Ofertuesit të Kualifikuar:

Numri i Regjistrimit të Kualifikimit të Ofertuesit:

Emri i Subjektit të Ri: Ndër. e Re.....Sh.P.K.

Nr. i Tenderit:

ÇMIMI I OFERTËS – SHËNO ÇMIMIN E OFERTËS QË JU SYNONI TË PAGUANI PËR SUBJEKTIN E RI NË SHIFRA

Qindra Milionë	Dhjetëra Milionë	Milionë	Qindra Mijë	Dhjetëra Mijë	Mijëra	Qindra	Dhjetëra	Njësi

NË FJALË

[.....]

SHËNIM 1: NË RAST TË ÇFARËDO MOSPËRPUTHJE NË MES TË SHIFRAVE QË GJENDEN NË TABELËN MË LARTË, SHUMA E PLOTËSUAR DHE SHUMA E THEKSUAR MË LARTË ME FJALË, E FUNDIT (SHUMA NË FJALË) MË E FUNDIT DO TË MBIZOTËROJË DHE DO TË LEXOHEM DHE TRAJTOHEM SIKURSE ÇMIMI I OFERTËS. NË ÇFARËDO RASTI KUR SHUMA E PËRSHKRUAR ME SHIFRA DHE FJALË, TË DYJA, NUK JANË TË LEXUESHME, OFERTA E OFERTUESIT DO TË DISKUALIFIKOHET.

SHËNIM 2: OFERTUESIT POTENCIAL DUHEN TË JENË TË VETËDIJSHËM SE PËRVEÇ ÇMIMIT TË OFERTËS ATA JANË TË OBLIGUAR TË PAGUAJNË SHUMËN SHITESË PREJ EURO **1.250,00**, DUKE QENË SHUMË E KAPITALIT THEMELUES FILLESTAR

PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË RI PËR TË CILËN AGJENCIA DUHET TË KOMPENZOHE

.....
Nënshkrim për dhe në emër të Ofertuesit të Kualifikuar

Ky nënshkrim po ashtu konfirmon se ofertuesi i kualifikuar pranon shënimet më lartë dhe pajtohet që të obligohet me deklaratën e bërë këtu.

Emri & Mbiemri:

Data:

SHTOJCA C

“FORMULARI PËR DORËZIMIN E OFERTËS”

KJO LETËR DUHET TË PËRFSHIHET NË NJË ZARF TË NDRYSHËM NGA ÇMIMI I OFERTËS (NË PËRPUTHSHMËRI ME NENIN 8.3 (a) (i) TË KËTYRE RREGULLAVE TË TENDERIT)

Për: Agjencinë Kosovare të Privatizimit
Ilir Konushevc Nr. 8
Prishtinë
Kosovë

Të nderuar zotërinj,

Emri i plotë e ofertuesit të kualifikueshëm:

Numri i regjistrimit të kualifikueshmërisë:

Emri i subjektit të ri:

Nr. i tenderit:

Të gjitha termat në këtë formular që fillojnë me shkronjë të madhe do të ketë kuptimin e njëjtë të përkufizuar në këto rregulla për tender, përveç nëse është përkufizuar ndryshe. Ofertuesi i kualifikueshëm konfirmon se është obligues për subjektin e ri.

Bashkangjitur:

DOKUMENTI	BASHKANGJITUR – PO OSE JO?
Kopja e Formularit për regjistrimin e kualifikueshmërisë	
Dokumenti bankar origjinal nga një bankë e mirënjohur (e jo ndonjë bankë e cila është e regjistruar në një vend i cili është në “listën e zezë” të Grupit Punues për Veprime Financiare (“FTAF”)), i cili konfirmon që ofertuesi do të ketë qasje në mjete të mjaftueshme gjatë tërë periudhës së tenderit për të paguar Çmimin e Ofertës së tij dhe Kapitalin Themelues Fillestar. Dokumenti i tillë bankar nuk duhet të jap vlerën e Çmimit të Ofertës së Ofertuesit të Kualifikueshëm.	

Dëshmi e cila tregon që Tarifa për Dorëzimin e Ofertës është transferuar në llogarinë e caktuar nga Agjencia.	
Dëshmi e cila tregon se Depozita e Ofertës është transferuar në llogarinë e caktuar nga Agjencia.	
Letra origjinale e nënshkruar në mënyrë të rregullt nga apo në emër të ofertuesit që deklaron se Ofertuesi pajtohet të merr përsipër obligimet e përmbledhura në Aneksin E dhe F të këtyre Rregullave të Tenderit dhe në Kontratën e Shitjes.	

Ofertuesi i kualifikueshëm (i emëruar më lartë) me dorëzimin e kësaj oferte, pranon dhe konfirmon se:

- Iu nënshtrohet kushteve dhe konditave të cekura në Rregullat e Tenderit
- Nuk është Ofertues me ndalese ofertimi për qëllime të këtyre Rregullave të Tenderit
- Ka pranuar dhe lexuar Memorandumin Informues për Ndër. e re(-ja) dhe modelin e Kontratës për Shitje
- Ka qenë i informuar se ekziston një zyre me të dhëna që përmban informata dhe dokumentacion të rëndësishëm, përfshirë këtu edhe dokumentin e quajtur “Disa Rreziqe Ligjore dhe të tjera“, në lidhje me Ndërmarrjen Shoqërore, Artikujt e Tenderuar dhe Ndërmarrjen e Re, të cilat mund të ndikojnë në vendimin e tij për të dorëzuar ofertën dhe/ose në çmimin e ofertës,
- I është dhënë mundësia që ta vizitoj këtë zyre të të dhënave dhe se ka vizituar zyrën e të dhënave apo me qëllim ka marrë rrezikun që mos ta vizitoj zyrën e të dhënave
- nëse është ofertues fitues pajtohet që shitja e Ndërmarrjes së Re do të bëhet kryesisht në formën dhe përmbajtjen e Modelit të Kontratës së Shitjes e cila ofrohet së bashku me Dokumentet e Ofertimit.
- Agjencioni do të përmbyll shitjen e Ndërmarrjes së Re vetëm me çmimin më të lartë të ofertuar.

.....
Nënshkrimi
Për dhe në emër të Ofertuesit
Emri:
Data:

SHTOJCA D

“FORMULARI I DOKUMENTIT BANKAR”

- **KJO LETËR DUHET TË PËRFSHIHET NË NJË ZARF TË NDRYSHËM NGA ÇMIMI I OFERTËS (NË PËRPUTHSHMËRI ME NENIN 8.3 (a) (iii) TË KËTYRE RREGULLAVE TË TENDERIT**
- **NË KËTË LETËR NUK DUHET TË JEPET VLERA E ÇMIMIT TË OFERTËS SË OFERTUESIT KUALIFIKUESHËM**

[TË SHKRUHET ME LOGON E BANKËS]

Për: Agjencinë Kosovare të Privatizimit
Ilir Konushevcu Nr. 8
Prishtinë
Kosovë

Nga: [shkruani emrin e bankës]

Lënda: Oferta e [shkruani emrin e ofertuesit të kualifikueshëm] për Ndërmarrjen e Re “Famipa” Sh.P.K./ Vala 49.

(Të gjithë termat që fillojnë me shkronjë të madhe do ta kenë të njëjtin kuptim të definuar sikurse në Rregulla të Tenderit për Ndër.e.Re “Famipa” SH.P.K veç nëse ndryshe definohet).

Theksojmë se [shkruani emrin e ofertuesit të kualifikueshëm] është klient i bankës tonë. Ne kemi diskutuar qëllimin e [shkruani emrin e ofertuesit të kualifikueshëm] për të dorëzuar ofertë për blerjen e Ndër.e.Re “Famipa” SH.P.K, sipas numrit të tenderit të AKP-së [shkruani numrin e tenderit të caktuar nga AKP-ja].

Pas shqyrtimit të mjeteve të [shkruani emrin e ofertuesit të kualifikueshëm] të depozituara në llogarinë e tij/saj bankare në bankën tonë dhe burimet tjera të mjeteve, ne mendojmë se do të ketë qasje në mjete të mjaftueshme për të paguar çmimin e ofertës së tij dhe kostot tjera përkatëse (përfshirë këtu, por jo kufizuar në, 1.250 € për kapitalin themelues fillestar) gjatë afatit të tenderit, në pajtim me të gjitha kushtet dhe afatet e përcaktuara në rregullat e tenderit përkatës Ndër.e.Re “Famipa” SH.P.K.

Ne konfirmojmë se jemi bankë e regjistruar në [shkruani vendin], vend i cili nuk gjendet në “listën e zezë” të Grupit Punues për Veprime Financiare (FATF).

Sinqerisht juaji,

.....

Emri i nënshkruesit:.....

Titulli i nënshkruesit:

Emri i bankës:

Data

SHTOJCA E

KUSHTET E OFERTES SE SPIN OFF-it

A. OBLIGIMET KONTRAKTUESE

Obligimet e mëposhtme dhe mekanizmat për përmbushjen e këtyre obligimeve, të përfshira në këto Rregulla të Tenderit dhe rrjedhimisht në Kontratën e Shitjes janë detyruese për Blerësin e Ndërmarrjes së Re “Famipa” Sh.P.K.:

- Ofertuesi apo Blerësi i ardhshëm i Ndërmarrjes së Re “Famipa” Sh.P.K është i obliguar që të ruaj aktivitetin e prodhimit dhe përpunimit të metaleve (prodhimtarinë origjinale të NSH-së) së paku për tri (3) vitet e ardhshme dhe ky aktivitet duhet të vazhdoj menjëherë pas nënshkrimit të kontratë së shitjes;
- Pajisjet dhe makineria e Ndërmarrjes së Re duhet të mbeten në të njëjtin vend, pra blerësi nuk do të çmontoj dhe dislokoj pajisjet dhe makinerinë ekzistuese së paku për periudhën e përcaktuar tri (3) vjeçare.

Ne rast të mospërmbushjes nga ana e Blerësit të ardhshëm të këtyre obligimeve të përcaktuara në këto Rregulla të Tenderit dhe Kontratën e Shitjes, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë apo pasardhësi juridik, do të mund të ushtroj dënimet kontraktuese të cilat do të përfshijnë 30% të çmimit të shitjes së Ndërmarrjes së Re së Re “Famipa” Sh.P.K.

Çdo Ofertues i Kualifikuar duhet të dorëzoj ofertën e cila përfshinë: çmimin e blerjes; dhe një letër të nënshkruar ashtu siç është përcaktuar nga/dhe në emër të ofertuesit i cili i kupton obligimet kontraktuese lidhur me operimet e Ndërmarrjes së Re.

Detajet që i përkasin këtyre obligimeve dhe mekanizmat e zbatimit do të paraqiten në Kontratën e Shitjes.

ANEKSI F

B. MONITORIMI I PERMBUSHJES SE OBLIGIMEVE KONTRAKTUESE

Përmbushja e obligimeve kontraktuese të paraqitura më lartë, do të monitorohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) apo pasardhësi i saj juridik, si vijon:

- Blerësi është i obliguar që t'i raportoj me shkrim Agjencisë apo pasardhësit juridik të saj, për vazhdimin dhe mbajtjen e aktivitetit të njëjtë të biznesit, çdo gjashtë (6) muaj për tri (3) vitet në vijim, nga data e nënshkrimit të Kontratës së Shitjes.
- Gjatë periudhës së monitorimit Agjencia apo pasardhësi i saj juridik, në rrethana të veçanta, ka të drejtë të realizoj takime dhe vizita të jashtëzakonshme në Ndërmarrjen e privatizuar, me një njoftim paraprak prej 24 orësh. Qëllimi i takimeve dhe vizitave është verifikimi i përmbushjes së obligimeve dhe kushteve kontraktuese.

Verifikimi i situatës në përgjithësi nga ana e Agjencisë apo pasardhësit juridik të saj, nuk përjashton mundësinë e verifikimit të situatës edhe nga organet e tjera publike të Republikës së Kosovës të autorizuara me ligj.

Në rast të mospërmbushjes të këtyre obligimeve të përcaktuara me këto Rregulla të Tenderit dhe Kontratën e Shitjes nga ana e Blerësit, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë apo pasardhësi juridik i tij, do të mund të ushtroj dënimet kontraktuese, të cilat do të përfshinë 30% të çmimit të shitjes së kësaj Ndërmarrje të Re.